

VENDIM
Nr. 321, datë 29.5.2024

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TEK MINISTRIA E DREJTËSISË, PËR DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BURGJEVE, TË PRONËS ME NR. 448, ME EMËRTIMIN “ISH-BATALION AT”, ME VENDNDODHJE NË BICAJ, KUKËS, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, TË NDRYSHUAR, SI DHE PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 1068, DATË 29.12.2010, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Mbrojtjes tek Ministria e Drejtësisë, për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, të pronës me nr. 448, me emërtimin “Ish-Batalion AT”, me vendndodhje në Bicaj, Kukës, sipas planrilevimit, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për nevoja të Institucionit të Paraburgimit Kukës.

2. Prona me nr. 448 hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar.

3. Prona e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, i shtohet listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 1068, datë 29.12.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të IEVP Burgu nr. 325, Burgu Vaqar, Burgu nr. 302, Spitali i Burgut Tiranë, IEVP Shënkoll, Lezhë, IEVP Bëncë, Tepelenë, IEVP Rrogozhinë, IEVP Lushnjë (fshati Kosovë, Komuna Fierzë, Elbasan) dhe të godinës së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Drejtësisë, për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve”, të ndryshuar.

4. Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve u ndalohet të ndryshojnë destinacionin e përdorimit të pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojnë ose t’ua japin atë në përdorim të tretëve.

5. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

Prona nr.448 " Ish Batalioni AT" Bicaj, Kukës

PRONARI: REPUBLIKA E SHQIPËRISË, MM, (FT)

DATE 03/05/2024 QËLLIMI Transferim nga MM te MD

VENDNDODHJA

Bashkia Kukës ZVASHK Kukës Nr.Pasurisë 727/3 Z.K 2839 Indeksi i Hartës KU-OSMANAJ-54


TE DHËNAT E PASURISË

Lloji i pasurisë Sip e pasurisë 29461.92m² Sip e gjurmës së ndërtimit 2309m² Nr. kateve 1 Nr. pemeve

Nord = 4651158.80
East = 533385.93

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE (KRGJSH)

Nord = 4651158.80
East = 533825.84



Shpjeguese:

Sip. e përgj. e pronës = 29461.92m²

Sip. e përgj. e gjurmës së ndërtimit = 2309m²

Kufiri i pronës

Nord = 4650807.73
East = 533385.93

SH 1: 2500

METRA

Nord = 4650807.73
East = 533825.84

NR	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI I KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT
1	Veri				K51726024H
2	Lindie				
3	Jug				
4	Perendim				

REALIZOI PËR IGJIU

Ing. Eris Ndrukaj

KONFIRMOI PËR IGJIU

DREJTORI MArch. Teuta KANXHERI

REALIZOI PËR ASHK

Specialisti

DVASHK

Nënshkrimi

KONFIRMOI

Përgjegjësi/Drejtori

Nënshkrimi/ Vula

TEKNOLOGJIA E MATJEVE Z-Zyrë; O-Ortofoto.

PËRCAKTIMI I KUFIRIT: Sipas dokumentacionit hartografik arkivor, HTR.

Shënim: Ky plan rilevimi u rihartua në zbatim të shkresës të Komandës FT nr.2447/1, datë 02.05.2024. Bazuar në dokumentacionin hartografik marrë në arkivin e IGJIU-s, HTR-së dhe kartelës të pasurisë të paluajtshme b/lidhur shkresës, ortofoto e vitit 2015-2016.

PRONARI: REPUBLIKA E SHQIPËRISË, MM (Forca Tokësore)

MIRATOHET

KOMANDANTI I FORCËS TOKËSORE

Gjenerali Major Irf XHEBEXHIA